Shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se **800 fjalë**

# Analiza&Komente

# Shoqëria Civile, ndikim pozitiv në shoqëri

Cili është imazhi i shoqërisë civile? Çka mendon opinioni publik, por edhe aktorët tjerë për sektorin? Kush e krijon imazhin për sektorin dhe cilat mesazhe përcillen tek opinioni publik nga aktorë të ndryshëm rreth këtij sektori? A vlerësohet realisht puna e shoqërisë civile në Kosovë? Këto janë pyetjet që u diskutuan në sallonin e së martës organizuar nga D4D, i cili u mbajt javën e kaluar.

Ky editorial synon të përmbledhë argumentet dhe përfundimet e këtij debati.

Për të diskutuar për imazhin e sektorit, është e rëndësishme të theksohet që përveç organizatave jo-qeveritare, pjesë e rëndësishme e shoqërisë civile janë edhe grupet e qytetarëve të organizuar dhe nismat tjera që jo patjetër regjistrohen ose formalizohen. Madje edhe në nivel individual, ata që krijojnë opinion për çështje të interesit publik hyjnë në kuadër të shoqërisë civile. Përderisa në Kosovë nismat qytetare ende nuk po arrijnë që të marrin rol domethënës në zhvillimet shoqërore, shembulli i protestave qytetare në Maqedoni (i njohur si "revolucioni laraman") e tregon që rëndësinë e angazhimit qytetar pa pasur nevojë të formalizohet në organizata të regjistruara.

Imazhi në vetvete është kategori subjek-



**Shkëlqim Hysenaj**

Sallonet e së martës janë një nismë javore e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D). Salloni ka format gjysmë-formal sipas rregullës Chatham House, dhe pa prani të medieave. Diskutimi mbledh rreth vetes

nga organizatat e mëdha dhe lënie anash të shumë punëve të mira që bëhen në zona jashtë kryeqendrës. Kjo krijon përshtypjen që vetëm nëse përkrahesh nga donatorët e huaj mund të arrish ndonjë ndryshim.

Kanalet e komunikimit me publikun vlerësohen si shumë të rëndësishme për krijimin e një imazhi të drejtë për punën e sektorit. Përderisa aktivizmi qytetar është në nivel shumë të ulët, vetë organizatat e shoqërisë civile nuk kanë ndonjë nivel të lartë të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarë. Disa mendojnë që pikërisht OJQ-të janë ato që kanë ngulfatur aktivizmin qytetar, duke u shndërruar në një treg për punësim të cilët më shumë kujdesen që të mbajnë raporte me donatorin/punëdhënësin sesa me qytetarët. Në anën tjetër, medieat mbesin mënyra kryesore e informimit të qytetarëve rreth sektorit. Duke qenë të interesuara për lajme të "profilit të lartë", lënë jashtë vëmendjes së tyre shumë nisma e arritje të shoqërisë civile në fshatra e qytete gjithandej vendit. Medieat i japin mjaft hapësirë edhe politikanëve të cilët rregullisht ngrisin dyshime mbi financimin e sektorit, "agjendat e fshehura" dhe të tjera, e të cilat më shumë vlerësohen

UBT
LEADERSHIP and INNOVATION
Education | Research | Training | Consulting | Certification

PROGRAMET E AKREDITUARA

SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI
(Baçelor dhe Master)
- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Intelegjente
- Informatikë Biomjeksore
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim

MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI
(Baçelor dhe Master)
- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistikë dhe Prokurim

MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT
(Baçelor dhe Master - **i vetmi i akredituar në vend**)
- Menaxhim i Mekatronikes
- Automatizimi Industrial dhe Kontrolli i Procesit
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Robotikë dhe Sisteme Intelegjente
- Inxhinieri Biomjeksore
- Inxhinieri e Telekomunikimit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieria e Aeronautikes

SHKENCA POLITIKE (Baçelor)
- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integrime Evropiane
- Administratë Publike

SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT
(Baçelor dhe Master)
- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistikat, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komerci Elektronik (E-Komerci)

ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR
(Baçelor dhe Master)
(I vetmi privat i akredituar në vend)
- Arkitekturë e Qendrueshme
- Menaxhim Urban
- Restaurim Arkitekturor
- Dizajn i Interierit

INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor dhe Master)

kush e jep një vlerësim të tillë. Megjithatë, disa të dhëna ekzistuese hedhin dritë mbi atë se si shihet shoqëria civile nga qytetarët dhe aktorët tjerë jashtë sektorit. Anketat me popullësinë e Kosovës për shumë vite me rradhë e nxjerrin shoqërinë civile si një nga sektorët më të besueshëm (me rreth 60% të qytetarëve që i besojnë sektorit), me vetëëm institucionet e sigurisë (Policia, FSK) të renditura më lart, ndërsa me Qeverinë, Kuvendint e partitë politike në fund të listës (15-20%, me trend të rënies). Edhe pse fushat ku sektori është më aktiv përfshijnë transparencën, llogaridhënien dhe sundimin e ligjit, ndikimi i shoqërisë civile në këto fusha mbetet i kufizuar. Kjo për faktin që ndryshimi në këto fusha është përgjegjësi e institucioneve kompetente, ndërsa shoqëria civile e ka të kufizuar hapësirën e veprimit dhe ndikimit të vet. Në anën tjetër, vlerësohet që ndikimi më pozitiv i shoqërisë civile është në demokratizimin e shoqërisë në përgjithësi, përfshirë edhe institucionet publike. E fundit por mjaft interesante, të tjerët jashtë sektorit kanë mendim më pozitiv sesa vet sektori rreth ndikimit të shoqërisë civile në këto dy fusha.

Shoqëria civile në Kosovë vjen nga të qenit bartëse e angazhimit gjithëshoqëror si reagim ndaj regjimit të viteve të 90-ta në një periudhë të përkrahjes së madhe nga donatorët e huaj pas vitit 1999. Kjo ka ndikuar në disa nivele. Ndikimi pozitiv i përkrahjes së donatorëve vërehet me zhvillimin e shumë organizatave të shoqërisë civile në nivele të larta profesionale, specializimin e tyre dhe ndikimin pozitiv në procese të rëndësishme në vend. Në anën tjetër, pasojat anësore përfshijnë një varësi nga donatorët e huaj për fonde dhe jo vetëm, dominim të hapësirës mediale sektorit sesa të bazuara në raste e fakte konkrete.

Pritjet nga sektori civil janë vendimtare për atë se si shihet ky sektor nga të tjerët, përfshirë nga publiku i gjerë. Një pjesë e politikës kosovare ka investuar gjatë që t'ia pamundësojë shoqërisë civile marrjen e qëndrimeve politike, ndërsa pjesë të tjera të spektrit politik e kërkojnë të kundërtën – pozicionimin e sektorit edhe në çështjet e pastra politike. Nga ky prizëm, hezitimi i sektorit që të deklarohet dhe përfshihet në zhvillimet ditore politike mund të shihet si një ngurrim e frikë e tyre që të sfidojnë pushtetin e politikën. Në anën tjetër, vetë organizatat e shoqërisë civile janë themeluar për të punuar në një fushë të caktuar, dhe çfarëdo dalje e organizatës jashtë asaj fushe mund të konsiderohet me të drejtë si keqpërdorim i emrit, kredibilitetit dhe investimeve që janë bërë në atë organizatë. Fundi i fundit, përderisa në nivel personal edhe aktivistët e shoqërisë civile mund të angazhohen në çështje nga më të ndryshmet (përfshirë ato politike), organizatat duhet të jenë të kujdesshme që të mos dalin nga misioni për të cilin janë themeluar.

Në fund, nuk duhet të harrohet që shoqëria civile e një vendi është rezultat i zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe nuk mund të konsiderohet e ndarë nga shoqëria që e prodhon. Me probleme shumë të mëdha në edukim, me një skenë politike problematike dhe qeverisje të cilës jo patjetër i konvenon angazhimi qytetar qëdhe të ballafaqohetuar me një të kaluar të gjatë patriarkale, të komunizmit dhe izolimit, shoqëria civile megjithatë ka ndikuar që Kosova të jetë një vend më i mirë.

politikanë e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus mbi temat e përzgjedhura. Fjala e hapjes postohet në www.youtube.com/user/TuesdaySalon. Secili Sallon përcjellet me një editorial që publikohet në gazetën Zëri të martën e ardhshme. Podcastet bazuar në editorialet mund të gjenden në d4d-ks.org/sallonet/podcast-per-sallone. Sot, më 1 nëntor, nga ora 16:45, mbahet salloni me temën: "Kontributi i mobilitetit të fuqisë punëtore në zhvillimin njerëzor dhe atë ekonomik"


- Inxhinieri Strukturore - Konstruktiv
- Menaxhimi i Ndërtimtarise dhe Teknologji
- Infrastrukturë Rrugore
- Inxhinieri e Ujerave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikes
- Inxhinieri e Materialeve

**JURIDIK** (LLB - Baçelor)
- Civile
- Penale
- Ndërkombëtare

**E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE** (LLM - Master)

**MEDIA DHE KOMUNIKIM** (Baçelor dhe Master)
- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhëniet me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

**POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM** (Master)
- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

**INXHINIERI E ENERGJISË** (Baçelor)
- Bazat e Burimeve të Energjisë
- Ruajtja e Energjisë
- Energjia Efiçiente
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Eklektikë Elektronike
- Sistemet e Qëndrueshme
- Izolimi i Ndërtesave
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes

**INXHINIERI E ENERGJISË EFIÇIENTE**
(Diplomë profesionale - I vetmi i akredituar në vend)

**INFERMIERI** (Baçelor)

**DIZAJN I INTEGRUAR** (Baçelor)
- Dizajn Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajn Mode dhe Tekstilit
- Dizajn i Produkteve
- Dekorim i Ndërtesave dhe Mobilimi

**SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI** (Baçelor)
- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko
Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400,
Email: info@ubt-uni.net